



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 472 Prot.

Tiranë, më 03 .04.2018

VENDIM Nr. 81, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor "Studimi i një varri monumental të identifikuar rishtasi në vendbanimin antikt të Klosit (Nikaia)-Rrethi Mallakastër"*, në kuadër të *Shkollës Doktorale të Arkeologjisë*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Jamarbër Buzo, Lavdosh Jahupaj, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor "Studimi i një varri monumental të identifikuar rishtasi në vendbanimin antikt të Klosit (Nikaia)-Rrethi Mallakastër"*, në kuadër të *Shkollës Doktorale të Arkeologjisë*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Jamarbër Buzo, Lavdosh Jaupaj, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

a) Vëzhgimi sipërfaqësor përreth varrit, në një perimetër të ngushtë për identifikimin e strukturave të reja funerare dhe pozicionimin topografik të tyre.

b) Dokumentimi i plotë i varrit me çati dyujëse:

- Prishja dhe zhvendosja e ledhit në një distancë të mjaftueshme nga varri
- Heqja e dherave që mbulojnë varrin nga jashtë
- Nxjerrja e dherave nga brendësia e varrit
- Pas dokumentimit të plotë të varrit parashikohet të ndërmerren punime konservuese.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

- c) Pastrimi dhe dokumentimi i plotë i strukturës shkëmbore që ndodhen pranë varrit.
- d) Planvendosja topografike e të dy strukturave në raport me murin rrethues të qytetit antik(sipas mundësive teknike)
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
 3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
 4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
 6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUBINA ZOTO